



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:224848

Datë: 07.08.2023

Numri i dokumentit: 04612385

C.nr.1513/16

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.H nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Nysret Mjeku, avokat në Prishtinë, rruga ”Garibaldi”, numër 61, kundër të paditurve Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Veton Bublaku, zyrtar ligjor pranë të paditurës, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, me seli në Vrellë, Lipjan, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Shkelzen Sopjani dhe Arian Prebreza, avokatë në Fushë Kosovë, Turkish Airlines – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, rruga ”Fehmi Agani”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Nushi, avokat në Prishtinë, rruga “Mujo Ulqinaku” 5/1, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 6,618.00€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 06.07.2023, të mbajtur me prani të paditëses dhe përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 20.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses H.H nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A., me seli në Prishtinë, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, me seli në Vrellë, Lipjan dhe Turkish Airlines – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, që në mënyrë solidare paditëses, t’ia kompensojnë dëmin material dhe jo material të shkaktuar në aksidentit ajror të datës 02.05.2016 dhe atë: në emër të dhimbjeve trupore fizike shumë prej 2,500.00€, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 3,500.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 210.00€, në emër të ushqimit

të përforcuar shumën prej 100,00€ dhe në emër të rehabilitimit klimatik shumën prej 308.00€, gjithsej shumën prej 6,618.00€, të gjitha këto me kamatë 8% në vit, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

## II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësja H.Hnga Prishtina, me datë 08.07.2016, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar në këtë Gjykatë, ka parashtruar padi kundër të paditurve Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A, me seli në Prishtinë, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, me seli në Vrellë, Lipjan dhe Turkish Airlines – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, në padi, seanca gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se tek e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A, ka bërë sigurimin e shëndetit në udhëtim, sipas policës së sigurimit numër 44094518, për periudhën kohore nga data 12.02.2016 deri më 12.02.2017. Paditësja ka udhëtuar për në Irland dhe nga atje është kthyer me datë 02.05.2016, me aeroplan të Kompanisë Turkish Airlines, sipas biletës me numër serie 3..... Gjatë aterimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, aeroplani i të paditurës së tretë, Turkish Airlines, del nga pista, ashtu që nga turbulencat e shkaktuara lëndohet paditësja, e cila ishte në cilësi të udhëtares. Si rezultat i lëndimeve trupore, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë, të konstatuara edhe me ekspertiza mjekësore. Mbi bazën e kësaj, i ka propozuar gjykatës, që të aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, të detyrohen të paditurat që në mënyrë solidare paditëses, t’ia kompensojnë dëmin material dhe jo material të shkaktuar në aksidentit ajror të datës 02.05.2016 dhe atë: në emër të dhimbjeve trupore fizike 2,500.00€, në emër të frikës së përjetuar 3,500.00€, për dëmin material: në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë 210.00€, në emër të ushqimit të përforcuar 100.00€, në emër të rehabilitimit klimatik 308.00€, gjithsej shumën prej 6,618.00€, të gjitha këtë në kamatë 8% në vit, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A., në përgjigje në padi, në seancat e shqyrtimit gjyqësore dhe fjalën përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Ka shtuar se të paditurës së parë i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë, pasi që në bazë të policës mbi sigurimin e shëndetit në udhëtim, të nënshkruara nga të dy palët, i siguruari ka kontraktuar sigurimin e shëndetit në udhëtim për seksionin 1 dhe 2, pra vetëm për shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e riadhesimit, ndërsa tek përjashtimet e policës së sigurimit shpenzimet e policës së sigurimit janë të mbuluara vetëm jashtë territorit të Kosovës. Në rastin e paditëses, e njëjta ka pësuar lëndime trupore në aeroplanin pronë e Turkish Airlines, si pasojë e rrëshqitjes së tij në pistën e të paditurës së dytë, Aeroporti Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, dhe jo jashtë territorit të Kosovës, siç është kontraktuar me policë të sigurimit të shëndetit në udhëtim. Lëndimet e paditëses janë si rezultat i aksidentit personal, të cilin seksion nuk e mbulohet me policën e sigurimit të të paditurës. Mbi bazën e kësaj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses, në raport me të, ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura e dytë, Aeroporti Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në seanca gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tersi kërkesëpadinë e paditëses me pretendimin se e paditura e dytë nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë, kjo për shkak se me asnjë prove nuk vërtetohet se e paditura e dytë ka përgjegjësi për shkaktimin e incidentit aeronautike, e me këtë rast edhe të shkaktimin të lëndimeve trupore të paditëses. Ka shtuar se paditësja nuk ka asnjë lidhje juridike me të paditurën, dhe për çdo fluturim që ndodhë, e paditura ka përgjegjësi vetëm për sigurimin e pritjes së udhëtareve, dhe dërgimin e tyre deri në aeroplan, pas hyrjes së udhëtareve në Aeroplan përgjegjësia bie mbi kompaninë e fluturimit. Komunikimet e pilotëve të aeroplanëve për aterim dhe ngritje bëhen përmes Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) dhe shkëputja e komunikimit mes pilotit dhe navigatorëve nuk është përgjegjësi e të paditurës së dytë. Lëndimi i paditëses, ka ndodhur në pistë, gjatë aterimit të aeroplanit, për çka nga Komisioni për Hetime të Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është bërë hulumtim, nga i cili ka rezultuar se incidenti i datës 02.05.2016 ka ardhur si pasojë e ekuipazhit të fluturimit, i cili nuk ka ndërmarr me kohë procedurën e kthimit. Andaj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses të refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura e tretë, Turkish Airlines – Dega në Kosovë, në seanca gjyqësor dhe fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses me pretendimin se kërkesëpadia është parashkruar, për faktin se dëmi i pretenduar i paditëses ka ndodhur me datë 02.05.2016, kurse parashtresa për zgjerimin e padisë edhe ndaj të paditurës së tretë është dorëzuar në gjykatë me datë 07.10.2021, ndërsa lejimi i zgjerimit të padisë është bërë me datë 25.01.2023. Në secilin rast është tejkaluar afati 5 vjeçar i parashkrimit të kërkesës i përcaktuar me nenin 352, e posaçërisht me nenin 357.2 të LMD-së. Gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar juridiksionin e gjykatës për të gjykuar këtë çështje juridike. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses në raport me të paditurën e tretë ta refuzoj në tërësi.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palës paditëse, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat relevante dhe atë: Policën e shëndetit në udhëtim me numër 44094518, lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “E...” Sh.A., Kushtet e përgjithshme të sigurimit në udhëtim, Biletën elektronike dokument udhëtimi i pasagjerit i datës 01.05.16 me numër serie 3....., Raportin e datës 02.05.2016 lëshuar nga Shërbimi Mjekësor i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – Limak Kosova, Raportin mjekësor të datës 09.06.2016 lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë “Aloka”, Fletë lëshimi me numër 6484 të datës 03.06.2016 lëshuar nga Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm - Banja e Kllokotit, Raportin nga konsulta e datës 15.06.2016, Raportin Neurokirurgjik të datës 21.06.2016 lëshuar nga Qendra Diagnostike Terapeutike “Rezonanca”, Raportin mbi incidentin serioz të avionit BOEING B 737-800, TC- JFY në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës me 02.05.2016, të botuar në Prishtinë, korrik të vitit 2018, dhe Ekspertizat mjekësore të datës 12.11.2020 punuar nga ekspertët Dr. Sabit Sllamniku- Ortoped dhe Dr. Nazmije Musliu- Psikiatër,

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha se bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u nisur nga pohimet e palëve ndërgjyqëse si në padi, përgjigje në padi dhe seanca gjyqësore, gjykatës i rezultojë se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 02.05.2016, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, ka ndodhur incident në komunikacionin ajror me avionin Boing B737-800, në pronësi të Turkish Airlines, sikurse nuk ishte kontestues as fakti se në këtë aeroplan, në kohën e incidentit, në cilësi të udhëtares ishte këtu paditësja Hava Halili.

Nga Polica e shëndetit në udhëtim me numër 44094518, e lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Esig” Sh.A., si dhe nga Kushtet e përgjithshme të sigurimit në udhëtim, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja H.H me të paditurën e parë ka kontraktuar policë të shëndetit në udhëtim me mbulose sigurorese të seksionit 1 – shpenzimet mjekësore dhe 2 – shpenzimet e riadhesimit, për periudhën kohore nga data 02.12.2016 deri me 02.12.2017, saktësisht për 90 ditë.

Nga Bileta elektronike dokumenti udhëtimi i pasagjerit, e datës 01.05.2016, me numër serie 3....., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja me datë 02.05.2016, kishte udhëtuar nga Dublini – Stambol – Prishtinë me kompaninë Trkish Airlines, fakt ky jo kontestues mes palëve.

Nga Raporti i datës 02.05.2016 i lëshuar nga Shërbimi Mjekësor i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – Limak Kosova, gjykata ka vërtetuar faktin se në datën e incidentit të komunikacionit ajror, paditësja ka pranuar shërbime mjekësore nga personali mjekësor, i cili ka identifikuar diagnozën e këtu paditëses Hava Halili.

Nga Raportet mjekësore nga konsulta i datës 15.06.2016 me konsultë nga Neurokirurgu, Flete lëshimi me numër 6484 i datës 03.06.2016 lëshuar nga Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm - Banja e Kllokotit, Raporti Neurokirurgjik i datës 21.06.2016 lëshuar nga Qendra Diagnostike Terapeutike “Rezonanca”, Raporti mjekësor i datës 09.06.2016 lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Aloka, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja pas datës së incidentit ka pranuar trajtime mjekësore dhe rehabilitim fizio terapeutik në institucionet gjegjëse shëndetësore.

Nga ekspertiza mjekësore e datës 12.11.2020, punuar nga ekspertët Dr. Sabit Sllamniku-Ortoped dhe Dr. Nazmije Musliu- Psikiatër, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja si pasojë e incidentit të komunikacionit ajror të datës 02.05.2016 ka pësuar lëndime trupore dhe përejtuar frikë. Eksperti ortoped, Dr. Sabit Sllamniku- Ortoped, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të

drejtpërdrejtë të paditëses, ka konstatuar se paditësja ka pësuar këto lëndime trupore: Distorsio vertebrae cervicalis dhe Syndroma cervicobrachialis lat.dex. Lëndimet e paditëses klasifikohen lëndime të lehta trupore. Si pasojë e lëndimeve të pësura paditësja ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditësh, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 14 ditësh dhe dhimbje të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 14 ditësh. Eksperti i psikiatrisë, Dr. Nazmije Musliu- Psikiatër, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, ka konstatuar se paditësja si pasojë e incidentit të komunikacionit ajror të datës 02.05.2016 ka përjetuar frikë primare dhe frikë sekondare. Frikë primare ka përjetuar 2 – 3 minuta, ndërsa frikë sekondare të intensitetit të lartë 2 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët 6 muaj.

Gjykata, ekspertizat mjekësore, atë të Ortopedisë dhe Psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, të punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Megjithatë, ekspertizat mjekësore edhe pse kanë provuar faktet lidhur me dëmin e pësuar nga paditësja, të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosje në këtë çështje juridike, pasi që kërkesëpadia e paditëses është refuzuar në tërësi.

Nga raporti mbi incidentin serioz të avionit Boeing B737-800, TC-JFY në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, më 2 maj 2016, i përpiluar në muajin Korrik 2018, nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, gjykata ka vërtetuar faktin se lidhur me incidentin në fjalë, ku edhe është lënduar paditësja, nga institucioni i autorizuar me ligj është bërë hetim, i cili ka rezultuar me konstatimin e shkakut dhe shkaktarit të incidentit. “Shkaktar i këtij incidenti serioz ishte lartësia shumë e madhe e kalimit të pragut të pistë, kombinuar me pozicionin e gjatë të aterimit dhe prekjen e vonuar në tokë përtej zonës së prekjes në tokë. Rezultati ishte prekja në tokë rreth 1 030 m përtej pragut të pistës 35. Menaxhimi i burimeve të ekuipazhit nuk ishte në përputhje me PSO-në e operimit. Ekuipazhi i fluturimit nuk ndërmori me kohë procedurën e kthimit. Kjo do të kishte parandaluar daljen nga pista”

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadiës është në dispozitat e Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Me nenin 918 të LMD-së përcaktohet se me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër. Kurse me nenin 923, paragrafi 1, të ligjit të njëjtë është përcaktuar se “në policë duhet të shkruhen palët kontraktuese, sendi i siguruar, respektivisht personi i siguruar, rreziku i përfshirë nga sigurimi, kohëzgjatja e sigurimit dhe periodha e depozitës, shuma e sigurimit ose se sigurimi është i pakufizuar, premia ose kontributi, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese.”

Me dispozitën e nenit 136, paragrafi 1, të LMD-së, është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, ndërsa me nenin 140 është përcaktuar se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.

Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Me nenin 357, paragrafi 1 dhe 2, të LMD-së është përcaktuar afati i parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit, ashtu që sipas paragrafit 1 “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin” ndërsa në me paragrafin dy të të njëjtit nen përcaktohet se “në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit.”

Gjykata, bazuar në dispozitat ligjore në fjalë dhe gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, gjeti se kërkesëpadia e paditëses ndaj të paditurave është e pa bazuar, andaj të njëjtën e refuzoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses ndaj të paditurës së parë Kompanisë së Sigurimeve “E....” Sh.A., dhe të paditurit të dytë Aeroporti

Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova për shkak të legjitimitetit real pasiv, ndërsa ndaj të paditurës së tretë, Turkish Airlines – Dega në Kosovë, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Gjykata, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses ndaj të paditurës së parë Kompanisë së Sigurimeve “E....” Sh.A., dhe të paditurit të dytë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova për shkak të legjitimitetit real pasiv, pasi që çështja e mungesës së legjitimitetit real pasiv për të paditurit i referohet raportit materialo juridike, e jo proceduralo-juridike.

Legjitimiteti real pasiv, i cili buron nga e drejta materiale, nënkupton se padia në gjykatë mund të parashtrohet ndaj palës e cila me qëndrimet ose veprimet e tij i shkel ose i mohon të drejtën e subjektit paditës, ashtu që në rastet e sigurimit të shëndetit në udhëtim legjitimitet real pasiv ka lëshuesi i policës së sigurimit vetëm për pjesën mbuluese të sigurimit me policë, ndërsa tek rastet e kompensimit të dëmit palë me legjitimitet real pasiv është subjekti i cili mban përgjegjësi për shkaktimin e dëmit, i cili në kuptim të nenit 136, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se "kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij", ka për detyrë që të kompensojë të dëmtuarin.

Gjykata, bazuar në policën e sigurimit të shëndetit në udhëtim me numër serik 44094518 dhe kushtet e përgjithshme të sigurimit të shëndetit në udhëtim, të lëshuar nga e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A., ka gjetur se pala paditëse, Hava Halili, tek e paditura e parë, ka kontraktuar sigurimin e shëndetit në udhëtim për periudhën kohore nga data 12.02.2016 deri më 12.2.2017, me numër të ditëve të udhëtimit prej 90 ditësh, me mbulesë siguroese - rreziku i përfshirë nga sigurimi vetëm për seksionin e shpenzimeve mjekësore dhe seksionin e shpenzimit të riadhesimit, por nuk ka kontraktuar edhe seksionin 3 të sigurimit të shëndetit në udhëtim e që është seksionin i aksidentit personal. Pra pala paditëse me këtë policë ka siguruar shëndetin në udhëtim për dy nga tri seksionet e sigurimit shëndetësor që ka ofruar këtu e paditura Kompania e Sigurimeve “E....” Sh.A., e të cilat seksione, bazuar në kushtet e përgjithshme të sigurimit të shëndetit në udhëtim, mbulojnë “shpenzimet për ndihmë të shpejtë mjekësore spitalore dhe kurim, si dhe shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme për riadhesimin e personit të siguruar si rezultat i sëmundjes ose dëmtimit fizik gjatë periudhës së sigurimit” si dhe “...qiranë e një mjete transporti ose të një ambulance ajrore ose përdorimin e



linjës së rregullt ajrore përfshirë shoqëruesit e kualifikuar të vërtetuar si të nevojshëm nga mjeku dhe të autorizuarit nga garuesi apo agjentët e tyre për riatdhesimin e një personi të sëmurë apo të dëmtuar seriozisht.” Incidenti i komunikacionit ajror, ku pala paditëse ka pësuar lëndime ka ndodhur me datë 02.05.2016, pra brenda periudhës së vlefshmërisë së policës së sigurimit me numër serik 44094518, mirëpo gjykata bazuar në të lartcekurat gjen se në rastin e paditëses nuk ka ndodhur ngjarja e siguruar përkatësisht rreziku i përfshirë nga sigurimi me policën e sigurimit me numër serik 44094518. Kjo sepse pala paditëse me padi ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material të pësuar në incidentin e komunikacionit ajror të datës 02.05.2016, për shkak të dhimbjeve fizike, frikës, ndihmës dhe kujdesit të personit të huaj, ushqimit të përforcuar dhe shpenzimet për rehabilitim klimaterik, por nuk ka parashtruar kërkesë ndaj të paditurës së parë për rimbursim të shpenzimeve të shërimit apo të riatdhesimit, e të cilat kanë qenë të kontraktuara me policën e sigurimit të shëndetit në udhëtim. Kërkesat jashtë mbulesës sigurorese si me policë të sigurimit të shëndetit në udhëtim, nuk e legjitimojnë këtu të paditurën Kompania e Sigurimeve “E...” Sh.A. për të qenë palë e paditur në këtë procedurë, pasi që nga pala e paditur nuk është provuar dhe pretenduar se ka ndodhur rasti i siguruar dhe nuk është pretenduar dhe provuar se dëmi i pësuar nga paditësja është me fajin e të paditurës së parë.

Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në raport me të paditurin e dytë, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova, për shkak të legjitimiteti real pasiv, bazuar në nenin 136 të LMD-së, pasi që nga prova e administruar në këtë procedurë kontestimore, nuk është provuar se dëmi i pësuar nga paditësja në incidentin e komunikacionit ajror të datës 02.05.2016 ka ndodhur me fajin e të paditurës së dytë. Bazuar në pohimet e palës paditëse si në padi, e të cilat nuk ishin kontestuar nga të paditurat, rezulton se paditësja, gjatë udhëtimit nga Irlanda për në Kosovë, në fazën e aterimit të aeroplanit, gjeri sa ishte brenda në aeroplanin e Turkish Airlines, si rezultat i daljes së tij nga pista, ka pësuar lëndime trupore. Daljes nga pista të aeroplanin e Turkish Airlines, bazuar në provat materiale të administruara në këtë proces kontestimore, përfshirë këtu edhe Raportin mbi incidentin serioz të avionit Boeing B737-800, TC-JFY në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, më 2 maj 2016, i përpiluar në muajin Korrik 2018, nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, nuk provohet se i ka kontribuar ndonjë lëshim i të paditurës së dytë, Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – Limak Kosova. Rrjedhimisht, pala paditëse me asnjë provë nuk ka provuar se aksidenti ajror i datës 02.05.2016, në të cilin lëndime

trupore ka pësuar paditësja, në cilësi të pasagjeres, është shkaktuar me fajin e të paditurës së dytë, gjë që do ta bënte përgjegjës të njëjtin për zhdëmtim të dëmit. Andaj, meqenëse se të paditurit të dytë i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë, vendosi që kërkesëpadia e paditëses ndaj të paditurit të dytë të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses ndaj të paditurës së tretë, Turkish Airlines – Dega në Kosovë, pasi ka vlerësuar si të bazuara pretendimet e të paditurës së tretë lidhur me parashkrimin e kërkesës për shpërblim të dëmit. Bazuar në nenin 357, paragrafi 1, të LMD-së kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.

Gjykata, bazuar në pohimet e palës paditëse si në padi, provat si bileta elektronike dokumenti udhëtimi i pasagjerit, e datës 01.05.2016, me numër serie 3....., raporti mjekësor i datës 02.05.2016 të përpiluar nga Shërbimi Mjekësor i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – Limak Kosova si dhe Raporti mbi incidentin serioz të avionit Boeing B737-800, TC-JFY në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ka provuar se incidenti me aeroplanin e të paditurës së tretë, ku paditësja është lënduar, ka ndodhur me datë 02.05.2016. Në kohën e incidentit paditësja ka qenë në aeroplanin e të paditurës së tretë, në cilësi të pasagjeres dhe në të njëjtën ditë ka pranuar edhe tretman mjekësor. Që do të thotë se e njëjta që nga data 02.05.2016 ka qenë e njohur me dëmin dhe shkaktarin e dëmit, daljen e aeroplanit nga pista, dhe nga kjo datë ka filluar rrjedhja e afatit të parashkrimit të kërkesës së paditëses. Paditësja, padinë në gjykatë e ka parashtruar fillimisht vetëm ndaj dy të paditurave, ndërsa me datë 31.03.2021, ka parashtruar propozim për lejimin e ndryshimit të padisë – zgjerimin me përfshirje në cilësi të palës së paditur edhe tani të paditurës Turkish Airlines – Dega në Kosovë. Nga koha kur paditësja ka qenë e njohur me dëmin dhe shkaktarin e dëmit e deri në kohën e parashkrimit të propozimit për lejimin e ndryshimit të padisë, kanë kaluar rreth 4 vite e 10 muaj, që do të thotë se në kohën e propozimit për lejimin e ndryshimit të padisë në kuptimin subjektiv, datë 31.03.2021, ka kaluar afati 3 vjeçar i parashkrimit të kërkesës, i përcaktuar me nenin 357, paragrafi 1 i LMD-së ku është përcaktuar se "Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin."

Gjykata, në këtë çështje juridike, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me incidentin e komunikacionit ajror të datës 02.05.2016, bazuar në nenin 356 të LPK-së,

zyrtarisht, ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i komunikacionit ajror – aviacionit civil dhe konform nenit 451, paragrafi 1, të LPK-së, ka obliguar palën paditëse që brenda afatit të përcaktuar të parapaguaj (deponoj) mjetet për marrjen e kësaj prove. Meqenëse pala paditëse nuk ka deponuar mjete për marrjen e provës, gjykata në seancën gjyqësore të datës 07.06.2023 ka revokuar aktvendimin në fjalë.

Gjykata ka refuzuar propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës së tretë, Turkish Airlines – Dega në Kosovë, që të shpallet jo kompetente dhe pa juridiksion për të vendosur në këtë çështje juridike, pasi që bazuar në nenin 93, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-051 për aviacionin civil, ku është përcaktuar se “përgjegjësia e një operatori ajror ndaj palëve të treta për dëme të shkaktuar në tokë rregullohet sipas dispozitave të HPEA dhe ligjeve civile të Kosovës (të drejtës civile të Kosovës).” Në rastin e paditëses dëmi është shkaktuar gjatë aterimit, përkatësisht pas prekjës së tokës, në pistë, me çka konform dispozitës në fjalë aplikohet legjislacioni civil i Republikës së Kosovës.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta, gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, pasi që nga asnjëra nga palët e paditura nuk kishte kërkesë për shpenzime.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e cekura me lartë.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr. 1513/16, datë 20.07.2023

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.